



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____. _____. 2021

PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE PËR IDENTIFIKIMIN E SUBJEKTEVE PRIVATE,
STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR IDENTIFIKIMIN E TYRE, SI DHE RREGULLAT
PËR REALIZIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 51, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurave për identifikimin e subjekteve private dhe të bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe subjekteve përgjegjëse për identifikimin.
2. Në varësi të shtrirjes territoriale, strukturat përgjegjëse për identifikimin e subjekteve private, të cilat do të përfshihen në infrastrukturën e paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit, janë:
 - a) bashkitë, të cilat:
 - i) identifikojnë subjektet private brenda territorit ku ushtrojnë kompetencat e tyre;
 - ii) pas identifikimit, informojnë prefektin e qarkut dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile mbi listën e subjekteve të identifikuara;
 - iii) kryejnë kontrollin e subjekteve private të identifikuara.
 - b) prefekti i qarkut, i cili:
 - i) në rast se e gjykon të nevojshme, identifikon subjekte private të tjera brenda territorit ku ushtron kompetencat e tij;
 - ii) informon Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile mbi listën e subjekteve të identifikuara;
 - iii) kryen kontrollin e subjekteve private të identifikuara.
 - c) Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, e cila:

- i) në rast se e gjykon të nevojshme, identifikon subjekte private të tjera, të paidentifikuara nga bashkitë apo prefekti i qarkut;
 - ii) kryen kontrollin e subjekteve private të identifikuara;
 - iii) mban regjistër në rang kombëtar mbi listën e subjekteve të identifikuara.
3. Subjektet private përfshihen në infrastrukturën e paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit në rastet kur:
 - a) kanë në pronësi ose kanë të drejta reale sipas përcaktimeve të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, mbi objekte që:
 - i) janë të pozicionuara brenda apo pranë qendrave të banuara, qendrave tregtare, zonave industriale, porteve, aeroporteve, autostradave dhe rrjetit rrugor kombëtar;
 - ii) garantojnë fushëpamje, të ketë pozicionim që mundëson vrojtimin dhe dëgjimin në distanca të largëta;
 - iii) garantojnë shikueshmëri, kanë pozicionim që mundëson dallimin me sy nga një pikë.
 - b) janë operatorë radiotelevizivë kombëtarë ose lokalë, ofrues të shërbimeve të komunikimit tokësor e satelitor, si edhe kompani telefonie.
4. Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet subjekteve private dhe strukturave përgjegjëse për identifikimin e tyre, subjektet private duhet:
 - a) të lejojnë hyrjen e personelit të ngarkuar me mirëmbajtjen dhe funksionimin e mjeteve dhe të pajisjeve të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit, pas njoftimit paraprak dy ditë pune para, përveç rasteve kur mjetet apo pajisjet janë dëmtuar apo janë jashtë shërbimit;
 - b) të lejojnë kontrollin, pas njoftimit paraprak dy ditë pune para, nga strukturat përgjegjëse të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, të mjeteve dhe të pajisjeve të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit, të vendosura në objektin e tyre;
 - c) të njoftojnë menjëherë strukturat përgjegjëse në rastet e dëmtimeve të dukshme të mjeteve dhe të pajisjeve të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit.
5. Me qëllim shmangien e mbivendosjes, strukturat përgjegjëse, sipas pikës 2 të këtij vendimi, koordinojnë punën për kryerjen e kontrolleve të përbashkëta.
6. Ngarkohen strukturat e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama